



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT NË KOSOVË - 2024

Shtator, 2025

MISIONI

“Rregullim i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

VIZIONI

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	6
2.	PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE	8
2.1	PERFORMANCA OPERATIVE – FURNIZIMI ME UJE	8
2.1.1	<i>Cilësia e Ujit</i>	8
2.1.2	<i>Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit</i>	9
2.1.3	<i>Matja e ujit</i>	10
2.1.5	<i>Konsumatorët e prekur nga presioni i ultë</i>	13
2.1.6	<i>Vazhdimësia e furnizimit me ujë</i>	14
2.1.7	<i>Plasaritja e gypave ne rrjetin e ujesjellesit</i>	16
2.1.8	<i>Uji i pa faturuar (Uji i humbur)</i>	17
2.1.9	<i>Volumi i ujit të shitur</i>	19
2.2	PERFORMANCA FINANCIARE-FURNIZIMI ME UJË	22
2.2.1	<i>Vlera monetare e shitjeve</i>	22
2.2.2	<i>Kostoja për njësi</i>	23
2.2.3	<i>Kostoja per njesi e ujit te prodhuar</i>	24
2.2.4	<i>Kostoja për njësi e ujit të shitur</i>	24
2.2.5	<i>Kostoja njësi e ujit te shitur e realizuar në raport me atë të planifikuar</i>	25
2.2.6	<i>Shpenzimet kapitale per ujësjellës</i>	26
2.3	PERFORMANCA OPERATIVE-SHËRBIMI I UJËRAVE TË NDOTURA	30
2.3.1	<i>Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara</i>	30
2.3.2	<i>Shpeshhtësia e bllokimit te rrjetit te kanalizimit</i>	30
2.3.3	<i>Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)</i>	31
2.3.4	<i>Ankesat</i>	32
2.4	PERFORMANCA FINANCIARE-SHERBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA	34
2.4.1	<i>Vlera e planifikuar e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (Euro)</i>	34
2.4.2	<i>Vlera e realizuar e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura (Euro)</i>	34
2.4.3	<i>Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura</i>	35
2.4.4	<i>Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura</i>	36
2.5	PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU-VE	40
2.5.1	<i>Arkëtimi i të ardhurave</i>	40
2.5.2	<i>Kthimi ne kapital</i>	42
2.5.3	<i>Shpenzimet operative</i>	43
2.5.4	<i>Efikasitet i stafit</i>	44
3.	PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË	46
4.	BESUESHMËRIA DHE SAKTËSIA E TË DHËNAVE:	47
	SHTOJCA 1: Besueshmëria e të dhënave-2023	50

SHTOJCA 2:Të dhenat dhe treguesit e datajuar te performancës	51
SHTOJCA 3:Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave.....	65
SHTOJCA 4:Përmbledhje treguesish-2023.....	68
SHTOJCA 5: Të dhëna statistikore-2023.....	69
SHTOJCA 6: PASQYRAT TARIFORE (2022-2023).....	70

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRRR	Baza Rregullatore e Aseteve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
PR	KRU “Prishtina”, Prishtinë
PZ	KRU “Hidroregjioni Jugor”, Prizren
PE	KRU “Hidrodrini”, Pejë
MIT	KRU “Mitrovica”, Mitrovicë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
GJA	KRU “Gjakova”, Gjakovë
FE	KRU “Bifurkacioni”, Ferizaj
GJI	KRU “Hidromorava”, Gjilan

1. HYRJE

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe grumbullimi e trajtimi i ujërave të ndotura janë shërbime thelbësore për mirëqenien dhe shëndetin publik. Ofruesit e këtyre shërbimeve (KRU-të) kanë përgjegjësi të lartë jo vetëm për të siguruar furnizim të vazhdueshëm, të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë të ujit, por edhe për mbrojtjen e mjedisit, si përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve ujore, ashtu edhe përmes trajtimit të duhur të ujërave të ndotura.

Në kushtet e ndryshimeve klimatike, urbanizimit të shpejtë dhe rritjes së kërkesave nga konsumatorët, monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së kompanive të ujësjellës-kanalizimeve është thelbësor për garantimin e shërbimeve cilësore dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore. ARRU, si rregullator ekonomik i sektorit të ujit, ka mandat të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ujit që janë cilësore, të besueshme, të sigurt dhe efikase, pa diskriminim, duke mbrojtur njëkohësisht mjedisin dhe shëndetin publik.

Në këtë kontekst, një nga mjetet kryesore është mekanizmi për nxitjen e konkurrencës në sektor, përmes analizës dhe krahasimit të performancës (“benchmarking”) mbi bazën e të dhënave të raportuara nga KRU-të.

Rezultatet e këtij raporti vjetor ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale të sektorit, sfidat me të cilat përballet dhe mundësitë për përmirësim. Kjo pasqyrë shërben si bazë e rëndësishme për hartimin e politikave dhe strategjive që synojnë të mbështesin furnizimin e qëndrueshëm dhe cilësor me ujë të pijshëm.

Në këtë raport, performanca e kompanive furnizuese me ujë të pijshëm është vlerësuar mbi bazën e një grupi treguesish kyç që pasqyrojnë efikasitetin operativ, cilësinë e shërbimit dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Gjatë periudhës së analizuar (2024), në nivel kombëtar është evidentuar një përmirësim i dukshëm në rezultatet e kompanive të ujësjellësit. Këto përmirësime janë rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për modernizimin e infrastrukturës, forcimin e menaxhimit operativ dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për konsumatorët, duke krijuar kështu baza më të qëndrueshme për zhvillimin e sektorit në të ardhmen.

Mesatarisht, kompanitë kanë arritur një normë furnizimi prej 97.3%, duke shënuar një përmirësim krahasuar me vitin paraprak, kur kjo normë ishte 96.9%. Ky progres reflekton një rritje të qëndrueshmërisë së furnizimit me ujë dhe një menaxhim më të mirë të infrastrukturës, veçanërisht në aspektin e reduktimit të ndërprerjeve të shërbimit.

Cilësia e ujit të furnizuar vazhdon të jetë në nivel të lartë, me 98.8% të mostrave të analizuar që i përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për ujë të pijshëm. Kjo tregon për përmirësime të vazhdueshme në proceset e trajtimit dhe kontrollit të cilësisë nga ana e ofruesve të shërbimeve.

Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit, IKSHPK dhe KRU “Prishtina” kanë raportuar për përqendrim të larta të manganit në ujin e papërpunuar të liqenit akumulues në Badovc. Edhe pas përpunimit në impiantin e Badovcit, këto përqendrimet nuk janë reduktuar në përputhje me standardet e aplikueshme, duke e bërë këtë një dukuri vjetore të përsëritur. Shkencërisht, mangani është një element kimik që gjendet natyrshëm në toka dhe shkëmbinj, sidomos përreth zonave minerare. Në përqendrimet të ulëta është i domosdoshëm për organizmat e gjallë, por në nivele të larta mund të jetë toksik dhe të ndikojë negativisht në shëndetin publik dhe në cilësinë e ujit të pijshëm.

Për këtë arsye, ARRU ka kërkuar që problematika të adresohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore, në bashkëpunim të ngushtë me IKSHPK, si institucioni përgjegjës për garantimin e cilësisë së ujit të ofruar nga KRU-të.

Progresi i arritur në efikasitetin e arkëtimit dëshmon, në përgjithësi, për një angazhim serioz të kompanive në drejtim të përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare. Kjo ka krijuar një bazë më solide për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të ujit të pijshëm në vend.

Megjithatë, mosrealizimi i caqeve të faturimit dhe mungesa e përmirësimit në efikasitetin e kostove operative në shumë KRU paraqesin jo vetëm një problem financiar, por edhe një sfidë të thellë strukturore, e cila ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, qëndrueshmërinë dhe përballueshmërinë e shërbimeve për konsumatorët.

Ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë shpenzojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave operative për mbulimin e kostove të personelit, të cilat përbëjnë rreth 60% të shpenzimeve operative. Së bashku me kostot e energjisë elektrike, këto arrijnë në mbi 80% të totalit të shpenzimeve operative, duke kufizuar hapësirën financiare për investime dhe përmirësime të tjera të nevojshme. Mungesa e planifikimit strategjik për optimizimin e proceseve, kontrolli dhe llogaridhënia e pamjaftueshme në menaxhimin e shpenzimeve, si dhe punësimi i stafit pa kriteret e qarta dhe pa nevoja reale operationale, janë faktorë që ndikojnë ndjeshëm në performancën financiare dhe operationale të KRU-ve. Si pasojë, kompanitë vazhdojnë të shpenzojnë më shumë çdo vit për prodhimin, shpërndarjen e ujit dhe trajtimin e ujërave të ndotura, gjë që krijon presion të vazhdueshëm për rritje të tarifave.

Për të tejkaluar këtë situatë, është e domosdoshme të ndërmerren masa strategjike që synojnë rritjen e efikasitetit operativ dhe financiar të sektorit. Këto përfshijnë investime në teknologji moderne, racionalizim të stafit dhe proceseve, trajnime të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve, reforma në menaxhim si dhe rritje të transparencës dhe llogaridhënies në monitorimin e shpenzimeve operative.

Në vitin 2024, investimet kapitale nga të hyrat vetanake kanë shënuar përmirësim të dukshëm, me normë realizimi prej rreth 69%, që paraqet rritje të efikasitetit krahasuar me vitin paraprak dhe tregon një angazhim më të madh të kompanive në zbatimin e projekteve dhe menaxhimin e burimeve financiare.

Faturimi real, që arrin vetëm rreth 40% të totalit të ujit të prodhuar, paraqet një problem serioz që ndikon drejtpërdrejt në të ardhurat dhe qëndrueshmërinë financiare të kompanive. Menaxhimi efektiv i faturimit është thelbësor për stabilitetin financiar dhe përmirësimin e shërbimeve. Për të rritur nivelin e faturimit, nevojiten investime të qëndrueshme dhe politika të qarta menaxhuese, si dhe zvogëlim i ujit të pafaturuar, i cili ndikohet si nga humbjet teknike (rrjedhje në pjesë të ndryshme të sistemit) ashtu edhe nga humbjet komerciale. Ky qëllim mund të arrihet vetëm përmes realizimit të shpenzimeve kapitale në përputhje me dinamikat e miratuara nga ARRU, duke përfshirë investime në zona të matjes (DMA), ujëmatësa, manometra, sisteme telemetrie dhe mirëmbajtje të rregullt të rrjetit shpërndarës.

Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Kosovë është një shërbim thelbësor për shëndetin dhe mirëqenien e popullatës. Gjatë vitit 2024 janë shënuar përparime të dukshme, veçanërisht në vazhdimësinë e furnizimit dhe cilësinë e ujit. Megjithatë, sfidat strukturore dhe operationale mbeten të konsiderueshme, përfshirë efikasitetin e kufizuar të kostove operative, nivelin e ulët të faturimit dhe menaxhimin e dobët të investimeve kapitale.

ARRU shpreh mirënjohjen dhe falënderon të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e këtij raporti, veçanërisht stafin e KRU-ve për bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt të të dhënave, si dhe ekipin e ARRU-së për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë përgatitjes së Raportit të Performancës për vitin 2024.

2. PERFORMANCA E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

2.1 PERFORMANCA OPERATIVE – FURNIZIMI ME UJE

2.1.1 Cilësia e Ujit

Furnizimi me ujë cilësor dhe të sigurt është një detyrë thelbësore e ofruesve të shërbimeve dhe një faktor kyç për shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik. Këta ofrues janë të obliguar të respektojnë standardet kombëtare të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2021 “Për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsumim Njerëzor”, si dhe standardet ndërkombëtare të OBSH-së dhe Direktivës së BE-së për ujë të pijshëm.

Në këtë raport, analiza dhe vlerësimi i cilësisë së ujit kundrejt standardeve në fuqi janë bazuar në të dhënat zyrtare të raportuara nga IKSHPK. Përfundimisht, për KRU Prishtina, për shkak të mungesës së të dhënave nga IKSHPK për periudhën raportuese, janë përdorur të dhënat e siguruara dhe të raportuara nga vet kompania. Këto të dhëna janë analizuar dhe vlerësuar në përputhje me kriteret e njëjta të cilësisë, me qëllim të pasqyrit të performancës në aspektin e kualitetit të ujit të furnizuar. ARRU ka mundur të sigurojë informacione edhe nga testimet e bëra në kuadër të laboratorëve të KRU-ve¹. Parametrat kryesorë të monitoruar përfshijnë tregues mikrobiologjikë (p.sh. baktere coliforme, E. coli), si dhe fiziko-kimikë (turbullira, ngjyra, erë, pH, TDS, nitrite, nitrate, mbetje klori, prania e metaleve të rënda etj.), të cilët përbëjnë tregues të drejtpërdrejtë të performancës së ofruesve të shërbimeve dhe kërkojnë menaxhim të vazhdueshëm, monitorim rigoroz dhe reagim të shpejtë ndaj çdo devijimi.

Niveli i përputhshmërisë së kualitetit të ujit, i prezantuar në diagramin 1 dhe 2, tregon përqindjen e testeve, fiziko-kimike dhe bakteriologjike, të cilat përmbushin vlerat referente vendore të cilësisë së ujit.




Figura 1. Përputhshmëria e testeve bakteriologjike

¹ KRU-të I kanë hartuar ‘Planin për Monitorim të Kualitetit të Ujit’, Të aprovuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë (IKSHPK), po ashtu të gjitha KRU përjashtuar KRU Mitrovica i kanë të akredituar laboratorët e tyre në kuadër të legjislativës, tek institucionin përgjegjës vendor.

Në aspektin bakteriologjik, gjatë vitit 2024 janë marrë dhe testuar gjithsej 13,059 mostra uji në nivel sektori, prej të cilave 98.9% kanë qenë në përputhje me standardet. Sipas të dhënave të paraqitura në Figurën 1, është vërejtur një përmirësim i përgjithshëm i cilësisë bakteriologjike të ujit të pijshëm në shumicën e KRU-ve.

Testet bakteriologjike tregojnë një rritje të ndjeshme të përputhshmërisë në pothuajse të gjitha kompanitë. Për shembull, KRU “Bifurkacioni” ka përmirësuar ndjeshëm normën e përputhshmërisë nga 87.5% në vitin 2023 në 95.8% në vitin 2024, duke reflektuar përparim të dukshëm në kontrollin e parametrave bakteriologjikë. Ndërkohë, KRU “Hidrodrini”, edhe pse ka shënuar një rënie të lehtë nga 99.1% në 97.3%, vazhdon të mbetet në një nivel të lartë të cilësisë.




Figura – 2. Përputhshmëria e testeve fiziko-kimike

Nga aspekti i përputhshmërisë së testeve fiziko – kimike, uji i pijshëm në vitin 2024 në raport me vitin 2023, është në nivel më të lartë të përputhshmërisë. Nga numri total prej 13,123 të mostrave fiziko-kimike të testuara, 98.8% e tyre janë në përputhje me standardet e aplikueshme.

Testet fiziko-kimike kanë treguar performancë shumë më të qëndrueshme dhe në rritje, me shumë KRU që arrijnë norma ideale prej 100% në vitin 2024 p.sh. KRU Prishtina, Hidroregjioni Jugor dhe KRU Gjakova. Ndërkohë që KRU Mitrovica ka rezultuar me një normë përputhshmërie afër 100%, duke reflektuar një cilësi shumë të lartë të ujit edhe në këtë zonë. KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidrodrini gjithashtu tregojnë një rritje në përputhshmëri, nga 95% në 97% dhe nga 90% në 95% përkatësisht.

Në përgjithësi, KRU-të kanë treguar një përmirësim të vazhdueshëm në cilësinë e ujit të monitoruar gjatë periudhës 2023-2024, duke reflektuar investimet në kapacitete laboratorike dhe përmirësimet në praktikat e monitorimit dhe trajtimit të ujit.

Edhe gjatë vitit 2024 sikurse edhe dy vitet paraprake, KRU Prishtina është përballur me vështirësi në aspektin e cilësisë fiziko-kimike të ujit të prodhuar dhe shpërndarë, kryesisht si pasojë e pranisë së manganit në Liqenin e Badovcit. Nga mostrat e marra për analizë gjatë këtij viti, 30 prej tyre kanë rezultuar jokonformë me standardet e lejuara për parametra kimikë, duke reflektuar ndikimin e kushteve natyrore dhe ndryshimeve sezonale në cilësinë e burimit. KRU Prishtinës i janë rekomanduar masa të vazhdueshme për kontroll më të rreptë të procesit të trajtimit dhe përmirësimit të monitorimit të parametrave kimikë, në mënyrë që të sigurohet furnizim i qëndrueshëm dhe cilësor me ujë për konsumatorët.

Kjo situatë, me shfaqjen e manganit, duket të jetë një dukuri vjetore e përsëritur. ARRU ka kërkuar që kjo problematikë të zgjidhet në kuadër të kërkesave/obligimeve ligjore-rregullatore dhe në bashkëpunim me IKSHPK, si institucion përgjegjës për garantimin e cilësisë së ujit të ofruar nga KRU. ARRU ka sugjeruar që KRU Prishtina të hartojë një plan dinamik, duke përfshirë veprimet dhe afatin kohor për eliminimin e këtij problemi.

Situata me cilësinë e ujit, pas shfaqjes së manganit në ujësjellësin e Prishtinës, po ashtu ka shqetësuar shumë banorët dhe autoritetet përkatëse. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e ujit në Kosovë (IKSHPK dhe KRU Prishtina) kanë ndërmarrë masa për monitorimin më të rregullt të cilësisë së ujit, përfshirë marrjen e mostrave dhe analizat laboratorike të ujit, si dhe kanë informuar banorët e zonave të prekura për/mos përdorimin e ujit të furnizuar nga ITU Badovc.

2.1.2 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

KRU-të si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura sigurojnë shërbime të ujësjellësit tek 83% e popullatës – siç është prezantuar në figurën 3. Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohet nga sistemet e menaxhuara nga KRU në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.




Figura 3. Përqindëja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit

Sipas të dhënave të paraqitura, mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit ka shfaqur një tendencë të përgjithshme rritjeje gjatë periudhës 2024 në raport me vitin 2023 në shumicën e KRU-ve.

KRU Prishtina ka shënuar përmirësim nga 83% në 88%, duke treguar një zgjerim të aksesit në shërbimet e ujësjellësit. KRU Hidroregjioni Jugor dhe Hidromorava kanë pasur rritje të moderuar, përkatësisht nga 66% në 72% dhe nga 63% në 66%. KRU Hidrodrini dhe Mitrovica gjithashtu kanë regjistruar rritje të lehta, duke arritur 87% dhe 84% mbulueshmërinë me shërbime të ujësjellësit.

KRU Gjakova vazhdon të ketë mbulueshmërinë më të lartë, duke ruajtur 99% për të dy vitet, që tregon një shërbim shumë të mirë në këtë zonë.

Një situatë e kundërt shihet te KRU Bifurkacioni, ku mbulueshmëria ka pësuar një ulje të lehtë nga 81% në 80%.

Në përgjithësi, mbulueshmëria sektoriale ka kaluar nga 79% në 83%, duke reflektuar një përmirësim të përgjithshëm në aksesin ndaj shërbimeve të ujësjellësit në nivel sektor.

Përmirësimi i treguesit të mbulueshmërisë me shërbimet e ujësjellësit gjatë vitit 2024 në raport me vitin 2023 është ndikuar edhe nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë, i cili ka mundësuar përditësimin dhe saktësimin e të dhënave demografike.

2.1.3 Matja e ujit

Përveç obligimit ligjor që KRU-të kanë për të faturuar konsumatorët e tyre në mënyrë të saktë, të drejtë sipas gjendjes së lexuar në ujëmatës, matja e ujit është gjithashtu një mjet i domosdoshëm për menaxhimin efikas të zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe për nxitjen e konsumatorëve për kursimin e ujit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për KRU-të të cilat përballen me sfidën e plotësimit të nevojave të popullsisë së tyre me ujë të pijshëm.




Figura 4. Përqindja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Mbulimi i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës gjatë vitit 2024 është 99.4 %. Nga numri total prej 481,510 konsumatorë, vetëm 2,339 konsumatorë ende nuk janë të pajisur me ujëmatës, kryesisht konsumatorë shtëpiak. Edhe pse është bërë progres në zvogëlimin e numrit të konsumatorëve pa ujëmatës, KRU 'Mitrovica' mbetet kompania me numrin më të lartë të konsumatorëve që nuk kanë ujëmatës, me 1,435 konsumatorë pa ujëmatës.

Sa i përket mirëmbajtjes dhe zëvendësimit periodik të ujëmatësve, shumica e ofruesve të shërbimeve të ujit nuk kanë plan të menaxhimit të ujëmatësve edhe pse ky plan kërkohet të hartohet sipas rregulloreve të brendshme të KRU-ve. Kjo situatë është edhe më shqetësuese duke marrë parasysh faktin se numër shumë i madh i ujëmatësve, që janë të instaluar tek konsumatorët, janë më të vjetër se 6 vite, madje ka ujëmatës me vjetërsi mbi 10 deri 25 vjet që ende janë në funksion, faktorë kryesor që ndikon shumë në saktësinë e regjistrimit të ujit të shpenzuar, e gabimet reflektohen në vëllimin e ujit të faturuar dhe humbjet e ujit. Ujëmatësit e vjetër zakonisht regjistrojnë më pak, rrjedhimisht janë në dëm të ofruesve të shërbimit. Korniza ligjore e aplikueshme e Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës (AMK) kërkon zëvendësimin/verifikimin e

ujëmatësve të konsumatorëve çdo 5 vjet. Pra, matja e ujit në çdo pikë konsumi është mekanizmi kryesor për menaxhimin e humbjeve dhe racionalizimin e shfrytëzimit të ujit.

KRU Bifurkacioni vazhdon të mbajë nivelin maksimal prej 100% të konsumatorëve me ujëmatës, që tregon një menaxhim të mirë dhe pajisjes së plotë të konsumatorëve me ujëmatës.

Një rënie të lehtë prej 0.3% në vitin 2024 (nga 100% në 99.7%), ka pësuar KRU Hidroregjioni Jugor e cila ka ndodhë për shkak të evidentimit të konsumatorëve pa ujëmatës gjatë vitit 2024.

Të pandryshuara në 99.8%, mbeten KRU Gjakova dhe Hidrodriini që tregon stabilitet dhe nivel të lartë të pajisjes me ujëmatës.

Një rritje modeste në vitin 2024, kanë KRU Prishtina dhe Hidromorava duke arritur në 99.8% dhe 99.6% respektivisht, që është një përmirësim i vogël por pozitiv.

KRU Mitrovica vazhdon të ketë performancën më të ulët, por shfaq një përmirësim të dukshëm nga 93.7% në 96.2% në vitin 2024, që tregon një fokus dhe përpjekje për të rritur mbulimin e konsumatorëve me ujëmatës.

Në përgjithësi, sektori ruan një nivel shumë të lartë të konsumatorëve të pajisur me ujëmatës, duke qenë afër 100% për shumicën e kompanive.

2.1.4 Ankesat e konsumatorëve

Ky tregues paraqet numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjetës të cilat vijnë nga konsumatorët për shërbimin e ujësjetës. Ankesat mund të shprehen në formë të shkruar ose përmes thirrjeve telefonike në qendrat e thirrjes ose direkt tek personat përgjegjës në KRU. Përditësimi, klasifikimi dhe analiza e ankesave të konsumatorëve janë elementë kyç për monitorimin dhe përmirësimin e performancës së KRU-ve.

Ankesat ofrojnë informacion të vlefshëm mbi dobësitë dhe problematikat në ofrimin e shërbimeve, duke identifikuar pikat ku nevojitet ndërhyrje. Natyra dhe frekuenca e ankesave duhet të shërbejnë si një paralajmërim për KRU-të, duke ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve për përmirësim. Ky tregues jo vetëm që ndihmon në identifikimin e fushave problematike, por gjithashtu mund të përdoret si një mjet për matjen e kënaqësisë së konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga KRU-të.

Tabela 1. Ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujit

KRU	Ankesat teknike			Ankesat komerciale		
	2023	2024	Raporti krahasues: 2024/2023	2023	2024	Raporti krahasues: 2024/2023
PR	17	2,676	15641%	1701	1,211	-29%
PZ	3,103	3,474	12%	462	895	94%
PE	4,369	3,335	-24%	43	132	207%
MIT	244	1,751	618%	176	174	-1%
GJA	1430	1064	-26%	300	1,185	295%
FE	99	361	265%	243	286	18%
GJI	80	94	18%	412	190	-54%
Totali	9,342	12,755	37%	3,337	4,073	22%

Në vitin 2024, ankesat teknike janë rritur me 37% në total krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje e konsiderueshme reflekton një përqendrim më të madh në raportimin e problemeve teknike, të cilat sipas kërkesave të ARRU-së, janë detajuar dhe raportuar veçmas (p.sh. mos furnizim me ujë, mungesë presioni, cilësia e ujit). KRU-të si Prishtina dhe Mitrovica kanë shënuar rritje jashtëzakonisht të madhe në numrin e ankesave teknike, duke sugjeruar ose një përmirësim në sistemin e raportimit, ose një shtim të problemeve teknike në zonat e tyre.

Në anën tjetër, ankesat komerciale kanë ndryshuar më pak në nivel sektori, me një rritje prej 22%. Megjithatë, disa KRU kanë shënuar rritje të madhe në këtë kategori, si KRU Hidroregjioni Jugor, Hidrodrini dhe KRU Gjakova. Këto ankesa lidhen kryesisht me çështje komerciale si faturat e mbingarkuara, leximi jo korrekt i ujmëmatësve, shënime të pasakta dhe regjistrimi i vonuar i pagesave.


Jo të gjitha KRU-të përdorin aplikacione të standardizuara dhe të dizajnuara mirë për përditësimin, klasifikimin dhe monitorimin e ankesave. Ndryshimet e mëdha në numrin e ankesave të raportuara nga viti në vit, siç shihet veçanërisht tek KRU Prishtina sugjerojnë probleme në mirëmbajtjen e bazës së të dhënave dhe në proceset e raportimit.

Ankesat teknike dhe komerciale shërbejnë si një indikator i rëndësishëm për cilësinë e shërbimit të ujësjellësit. Rritja e numrit të ankesave duhet të shihet si një mundësi për KRU-të që të përmirësojnë shërbimet, të përqendrohen në pikat e dobëta dhe të rrisin kënaqësinë e konsumatorëve.

2.1.5 Konsumatorët e prekur nga presioni i ulët

KRU-të janë të obliguara të furnizojnë në vazhdimësi konsumatorët e tyre me ujë me presion të mjaftueshëm² në rrjetin e ujësjellësit. Ky tregues definon numrin e pronave që ndikohen rregullisht nga presioni i ulët, duke përfshirë rastet aksidentale të herë pas herëshme të rënies së presionit.

Është e evidente se menaxhimi i presionit në rrjetin shpërndarës, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë që ka në kënaqshmërinë e konsumatorëve me shërbimet e ofruara të ujit, është metodë e rëndësishme për menaxhimin e humbjeve të ujit si dhe ruajtjen e jetëgjatësisë së rrjetit të ujësjellësit.



² Referenca Ligjore 'RREGULLORE NR.10/2019 PËR STANDARDET MINIMALE TË SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOV', thekson se: Në kushtet e zakonshme të përdorimit të ujit, presioni hidraulik në gypin e lidhjes së konsumatorit duhet të jetë jo më pak se një e gjysëm (1.5) bar dhe jo më shumë se shtatë (7) bar.

Figura 5. Pronat e ndikuara nga presioni ulët

Të dhënat tregojnë se ekziston një problem i pranishëm me presionin minimal të ujit për disa KRU, megjithatë besueshmëria e këtyre të dhënave është e kufizuar për shkak të mungesës së pajisjeve të matjes dhe monitorimit. Për të rritur cilësinë e shërbimit dhe për të menaxhuar më mirë humbjet e ujit, KRU-të duhet të përmirësojnë sistemet e tyre të monitorimit të presionit, duke ndarë rrjetin në zona presioni dhe duke instaluar manometra në pika kyçe të rrjetit.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën 5, disa KRU kanë raportuar përqindje të konsumatorëve nën presionin minimal.

Në vitin 2023, KRU Hidrodrini ka raportuar nivelin më të lartë të konsumatorëve me presion të pamjaftueshëm 1.59%, ndërsa në vitin 2024 ky tregues bie në 0%, që mund të interpretohet si një përmirësim apo si rezultat i mungesës së menaxhimit adekuat dhe monitorimit të presionit në rrjet.

Siç është përmendur, mungesa e manometrave në pikat kyçe të rrjetit dhe mosndarja e rrjetit në zona presioni e ul besueshmërinë e të dhënave. Kjo mund të shpjegojë pse disa raporte ndryshojnë ndjeshëm (p.sh. rënia drastike e KRU Hidrodrini në 2024). Gjithashtu, mungesa e monitorimit të vazhdueshëm ndikon në aftësinë për të identifikuar dhe adresuar problemet me presionin e ujit në mënyrë efektive. Është e rëndësishme që KRU-të të investojnë në instalimin e manometrave në pika kyçe të rrjetit dhe ndarjen e rrjetit në zona presioni për të pasur një monitorim më të mirë dhe menaxhim më efektiv.

Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të presionit është thelbësor për reduktimin e humbjeve të ujit dhe për të siguruar cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.

2.1.6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Monitorimi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë pasqyron treguesin e performancës i cili merr për bazë numrin e pronave të prekura / ndikuara nga disponueshmëria me shërbim të furnizimit me ujë dhe është ndarë në tre kategori: prona që kanë furnizim 24 orë në ditë, prona që kanë furnizim midis 18-23 orë në ditë dhe ato me më pak se 18 orë furnizim në ditë.

Në përgjithësi, furnizimi me ujë në Kosovë është përmirësuar në vazhdimësi si rezultat i investimeve në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në të gjitha KRU-të, megjithatë furnizimi i vazhdueshëm për 24 orë në ditë në disa KRU ende nuk mund të sigurohet, ndërsa të dhënat e raportuara për vazhdimësinë e furnizimit me ujë, ARRU i vlerëson të jenë me besueshmëri të ulët, pasi zonat e shërbimit ende nuk janë të ndara në zona të matura të ujit (DMA – District Metered Area) përmes të cilave do të monitorohej furnizimi i rregullt me ujë i konsumatorëve.

Tabela 2. Vazhdimësia e furnizimit me ujë e konsumatorëve

KRU	<18 h furnizim %		18-23 h furnizim %		24 h furnizim %	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024
PR	6.47%	5.23%	0.85%	1.59%	92.68%	93.18%
PZ	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
PE	2.29%	0.00%	0.00%	0.00%	97.71%	100.00%
MIT	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
GJA	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	100.00%	100.00%
FE	0.00%	0.00%	1.06%	0.98%	98.94%	99.02%
GJI	0.60%	0.17%	0.42%	0.81%	98.97%	99.02%

Tabela 2 paraqet të dhënat e raportuara të vazhdimësisë së furnizimit me ujë gjatë vitit 2023 dhe 2024. Vetëm KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Mitrovica, Hidrodrini dhe KRU Gjakova kanë raportuar furnizim të rregullt me ujë, katër KRU-të tjera kanë raportuar të kenë ndërprerje të furnizimit me ujë.

Nga numri i përgjithshëm i konsumatorëve të sektorit të shërbimeve të ujit, rreth 11,200 prej tyre kanë pasur mungesë të vazhdimësisë së furnizimit me ujë, përkatësisht 97.3% e konsumatorëve është raportuar të kenë pasur furnizim me ujë 24 h në ditë gjatë vitit 2024, 0.7 % e konsumatorëve kanë pasur furnizim 18-24 h në ditë si dhe 1.9% janë furnizuar më pak se 18 orë brenda ditës.

Sipas raporteve, KRU Prishtina ka mbi 10 mijë konsumatorë apo 6.8% në zonën e shërbimit që kanë pasur probleme të furnizimi të rregullt me ujë, kryesisht në disa zona në Fushë Kosovë, Podujevë dhe Lipjan. Reduktimet aplikohen me shumë gjatë sezonës së verës, mirëpo reduktimet vazhdojnë edhe gjatë muajve tjerë të vitit për shkak të mungesës së burimeve të ujit dhe keq përdorimeve të ujit.

Disa prej KRU-ve edhe përkunder raportimit se nuk kane pasur reduktime, në praktikë ka ndodhë e kundërta. Kjo ndikon drejtpërdrejt në besueshmërinë e të dhënave të raportuara dhe vështirëson analizën e saktë të situatës në nivel kombëtar. Megjithatë, për shkak të mosmbajtjes së evidencës së saktë dhe të plotë lidhur me mungesën e ujit të pijshëm, këto ndërprerje nuk janë reflektuar në raportimet zyrtare. Është e domosdoshme që të gjitha KRU-të të përmirësojnë sistemin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, duke e trajtuar vazhdimësinë e furnizimit me ujë si tregues kyç të cilësisë së shërbimit. Kjo tregon një mungesë të rëndësishme të korrektësisë dhe transparencës në menaxhimin dhe raportimin e vazhdimësisë së furnizimit me ujë, gjë që e vështirëson identifikimin dhe adresimin e problemeve reale në rrjet.




Figura - 6 Vazhdimësia e furnizimit me ujë

KRU 'Hidromorava', ka deklaruar se kanë aplikuar reduktime të ujit për një numër të vogël të konsumatorëve në disa lokalitete në njësinë operative Gjilan për shkaqe teknike. Ndërsa në KRU 'Bifurkacioni' probleme me mungesë të furnizimit të rregullt paraqiten në disa lokalitete si Komogllavë dhe Gërlicë gjatë sezonës së verës. Siç është shkruar më lartë, situata në teren mund të jetë edhe më e keqe për sa i përket këtij standardi të shërbimit pasi mungon monitorimi efektiv dhe në kohë reale i shpërndarjes së ujit në zonën e shërbimit. Kompanitë të cilat po ballofaqohen me vështirësi të furnizimit të vazhdueshëm me ujë kanë mundësi të bëjnë më shumë në zbutjen e këtij problemi përmes eliminimit në kohë të defekteve, identifikimi dhe adresimi i

kyçjeve të paligjshme (ilegale) të cilat janë burim keqpërdorimi enorm i ujit të pijshëm, ndërmarrjes së fushatave të detektimit të humbjeve të ujit, etj.

2.1.7 Defektet në rrjetin e ujësjellësit

Është një tregues tipik operativ i cili pasqyron gjendjen dhe efektivitetin e menaxhimit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit e shprehurë me numrin total të plasjeve/defekteve të gypave të ujësjellësit brenda një viti në raport me 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit.




Figura 7. Defektet e raportuara në rrjetin e ujësjellësit

Gjatë vitit të fundit, treguesi i defekteve në rrjet ka shfaqur një trend të lehtë përmirësimi, me mesataren që është ulur nga 193 defekte në 178 defekte për 100 km rrjet. Megjithatë, niveli i përgjithshëm mbetet i lartë, duke reflektuar sfidat infrastrukturore dhe nevojën për investime të vazhdueshme në mirëmbajtjen dhe rinovimin e rrjetit.

Mungesa e të dhënave të plota dhe të besueshme për pjesën dërrmuese të Kompanive Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve (KRU) mund të çojë në nënvlerësim ose mbivlerësim të treguesit të defekteve, duke vështirësuar vlerësimin e saktë të situatës së rrjetit dhe efikasitetit të mirëmbajtjes, si në nivel të përgjithshëm, ashtu edhe në nivele specifike brenda KRU-ve.

Sa i përket besueshmërisë së të dhënave për defektet në rrjetin e ujësjellësit, sipas vlerësimeve të raporteve të auditimit për vitin 2024, ajo varion nga 44% në KRU Prishtina, deri në 76% në KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidromorava. Vlen të theksohet se në vitin 2024, KRU Hidroregjioni Jugor ka instaluar dhe zbatuar një softuer të avancuar për menaxhimin dhe përditësimin e të dhënave të defekteve në rrjetin e ujësjellësit, gjë që ka përmirësuar ndjeshëm besueshmërinë e të dhënave mbi defektet në këtë kompanie.

2.1.8 Uji i pa faturuar (Uji i humbur)

Uji i Pa-Faturuar (UPF) përfaqëson pjesën e ujit të trajtuar dhe të futur në rrjetin shpërndarës e që nuk arrin të faturohet, pra humbjet e ujit që ndodhin përpara se uji të arrijë tek konsumatori dhe që nuk sjellin të ardhura për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit.

Në vitin 2024, UPF në nivel sektori ka arritur një nivel shumë të lartë, prej 63%, që do të thotë se më shumë se gjysma e ujit të prodhuar nuk faturohet dhe nuk gjeneron të ardhura. Ky tregues, megjithëse shprehet në përqindje dhe ka kufizimet e tij, ofron një pasqyrë të menjëhershme të gjendjes së infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit, që është në gjendje të rëndë dhe me humbje të mëdha të ujit.




Figura 8. Uji i pa-faturuar (%)

Nga figura 8 shihet se KRU Hidrodrini arrin nivelin e humbjeve në 80% duke u pasuar nga KRU Hidroregjioni Jugor me 73% të humbjeve të ujit të cilat prijnë në raport me të gjitha KRU-të.

Rritja e UPF krahasuar me vitet e mëparshme lidhet kryesisht me përmirësimin e metodologjisë së matjes së ujit të prodhuar, për shkak të instalimit të ujëmatësve funksionalë në të gjitha pikat e prodhimit. Kjo ka mundësuar një raportim më të saktë dhe më të besueshëm të volumit të ujit të prodhuar sipas leximit të gjendjes në ujëmatës, duke reflektuar në një rritje të UPF, e cila më parë mund të ishte nënvlerësuar.

Ky tregues thekson nevojën urgjente për investime në përmirësimin e infrastrukturës, reduktimin e humbjeve fizike dhe menaxhimin më efektiv të rrjetit për të zvogëluar humbjet dhe për të rritur të ardhurat e KRU-ve.

Aktualisht të gjitha KRU-të kanë të instaluar ujëmatës funksional në të gjitha burimet e ujit, dhe me kërkesë të ARRU-së, të dhënat e ujit të prodhuar duhet të monitorohen në mënyrë strikte nga personat përgjegjës.

Magnituda e vërtetë e problemit me humbjet e ujit bëhet më e dukshme kur paraqitet në vlera absolute.

Gjatë vitit 2024 është raportuar një vëllim rekord i humbjeve të ujit (UPF). Në nivel sektori, vëllimi i ujit të humbur është rritur nga 111.5 milionë m³ sa ishte në vitin 2023 në mbi 126.6 milionë m³ në vitin 2024, siç tregohet në figurën 9.




Figura 9. Vëllimi i ujit të pa-faturuar (m³)

Në vitin 2024 nga shtatë KRU-të janë prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët në total prej rreth 200.5 mil. m³, ndërsa janë faturuar për konsumatorët vetëm 73.9 mil. m³ apo 37%, ndërsa janë humbur mbi 126.6 mil. m³ (63%).

Përndryshe vetëm KRU Mitrovica ka shënuar ulje të UPF në vitin 2024, të gjitha KRU-të tjera kanë ngecur në pozitën e njëjtë apo kanë pasur përkeqësim tek ky tregues i performancës. Krahasimi i planifikimit dhe realizimit të humbjeve të ujit të dakorduara me KRU-të në procesin tarifor janë dhënë në tabelën 3.

Tabela 3. Vlera në përqindje e UPF: Planifikimi kundrejt realizimit (2023-2024)

KRU	2023		2024	
	Planifikim	Realizim	Planifikim	Realizim
PR	50.9%	57%	47.8%	58%
PZ	48.0%	71%	46.0%	73%
PE	54.4%	75%	51.8%	80%
MIT	46.6%	54%	44.1%	53%
GJA	36.2%	48%	34.7%	48%
FE	55.6%	46%	51.7%	46%
GJI	41.2%	52%	39.2%	52%
Mesatarja për Sektorin	47.9%	61%	46.0%	63%

Situata aktuale dhe sfidat në zvogëlimin e humbjeve të ujit nga KRU-të (2022-2024).

Çaçet e dakorduara me KRU-të për zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe të aprovuara përmes procesit tarifor për periudhën 2022-2024, përveç rastit të KRU Bifurkacioni, nuk janë arritur në asnjë KRU tjetër. Madje, në disa KRU, diferencat midis planifikimeve dhe realizimeve janë shumë të mëdha. Ky fakt tregon një dështim të përgjithshëm në sektor për të adresuar humbjet e ujit në mënyrë efektive.

Duke marrë parasysh situatën aktuale, ARRU po shqyrton një qasje të re për të trajtuar sfidën kryesore të sektorit, që është zvogëlimi i humbjeve të ujit, si dhe për të menaxhuar KRU-të që nuk kanë arritur rezultate të pritshme.

Për ciklin tarifar 2026-2028, ARRU do të përfshijë në metodologjinë tarifore planifikimet për zvogëlimin e humbjeve të ujit. Në këtë mënyrë mos përmbushja e caqeve të vendosura për humbjet e ujit do të ketë si pasojë uljen e tarifave për KRU-të përkatëse. Kjo masë synon të nxisë dhe të shtyjë KRU-të që të angazhohen më shumë në adresimin e humbjeve shumë të larta të ujit.

Zvogëlimi i humbjeve të ujit në rrjetin shpërndarës kërkon mobilizimin dhe koordinimin e të gjithë aktorëve në sektorin e ujit. Objektivat duhet të jenë të qarta, të arritshme dhe sfiduese.

ARRU kërkon nga KRU-të përmirësimin urgjent të menaxhimit të të dhënave për të rritur besueshmërinë e raportimeve dhe për të adresuar humbjet e ujit në mënyrë më efektive.

2.1.9 Volumi i ujit të faturuar (shitur) në raport me planin

Vëllimi i ujit të shitur ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin financiar të kompanive, pasi që sa më i lartë të jetë faturimi në raport me prodhimin, aq më të qëndrueshme janë financiarisht kompanitë. Shitjet volumetrike ndikojnë kryesisht në ngarkesën tarifore. Figura 10 tregon performancën e shitjeve të ujit krahasuar me planifikimet përmes procesit tarifar 2022-2024.




Figura 10. Përqindja e shitjeve (faturimit sasior) në raport me planin

Sipas figurës 10, KRU Bifurkacioni është e vetmja kompani që ka përmbushur 100% planifikimet për shitjen e ujit gjatë dy viteve 2024 dhe 2023, duke treguar një performancë optimale dhe të qëndrueshme. Të gjitha KRU-të e tjera nuk kanë arritur të realizojnë planifikimet e shitjeve volumetrike.

Më konkretisht, KRU Gjakova ka performancën më të dobët me 81% në 2024 dhe 82% në 2023, duke regjistruar ngecje prej rreth 19-18% në raport me planifikimet. KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Hidrodrini Prishtina, KRU Mitrovica, si dhe KRU Hidromorava, kanë realizuar shitje në intervalin 81%-95%, që tregon

ngecje të konsiderueshme krahasuar me pritshmëritë. Në nivel sektori, mesatarja e realizimit të shitjeve volumetrike është rreth 90% në 2024, që tregon ngecje në planifikimet për shitjet volumetrike.

Performanca jo e kënaqshme e shumicës së KRU-ve ndikon negativisht në efikasitetin financiar dhe qëndrueshmërinë e sektorit.

Tabela 4. Statistikat e të dhënave të realizuara dhe aprovuara 2023-2024

KRU	Të dhënat operative	Njësia	Historike 2023	Aprovuara 2024	Realizuara nga KRU-të 2024	% krahasuese 2024 / 2023	%krahasuese 2024: realizim/planifikim
PR	Uji i prodhuar	m ³	57,266,265	50,783,368	59,390,305	103.71%	116.95%
	Uji i humbur	m ³	32,628,665	24,293,522	34,165,268	104.71%	140.64%
	Uji i faturuar	m ³	24,637,600	26,489,846	25,225,037	102.38%	95.23%
	Konsumatorët	Nr	171,063	174,242	177,351	103.68%	101.78%
PZ	Uji i prodhuar	m ³	27,453,728	18,600,441	31,127,858	113.38%	167.35%
	Uji i humbur	m ³	19,382,589	8,558,026	22,658,352	116.90%	264.76%
	Uji i faturuar	m ³	8,071,139	10,042,415	8,469,506	104.94%	84.34%
	Konsumatorët	Nr	58,963	61,586	61,581	104.44%	99.99%
PE	Uji i prodhuar	m ³	38,641,481	23,184,851	48,238,121	124.84%	208.06%
	Uji i humbur	m ³	28,821,593	12,000,000	38,356,443	133.08%	319.64%
	Uji i faturuar	m ³	9,819,888	11,184,851	9,881,678	100.63%	88.35%
	Konsumatorët	Nr	57,063	57,195	59,520	104.31%	104.07%
MIT	Uji i prodhuar	m ³	27,527,413	23,783,890	28,007,939	101.75%	117.76%
	Uji i humbur	m ³	14,898,896	10,483,890	14,908,888	100.07%	142.21%
	Uji i faturuar	m ³	12,628,517	13,300,000	13,099,051	103.73%	98.49%
	Faturimi-Jug	m ³	7,742,743	8,500,000	7,749,885	100.09%	91.18%
	Faturimi-Veri	m ³	4,885,774	4,800,000	5,349,166	109.48%	111.44%
	Konsumatorët	Nr	49,635	43,646	51,809	104.38%	118.70%
GJA	Uji i prodhuar	m ³	15,726,213	15,824,028	16,202,875	103.03%	102.39%
	Uji i humbur	m ³	7,542,758	5,489,461	7,848,117	104.05%	142.97%
	Uji i faturuar	m ³	8,183,455	10,334,566	8,354,758	102.09%	80.84%
	Konsumatorët	Nr	47,631	49,326	49,730	104.41%	100.82%
FE	Uji i prodhuar	m ³	8,182,764	9,433,810	8,477,881	103.61%	89.87%
	Uji i humbur	m ³	3,793,223	4,875,070	3,941,925	103.92%	80.86%
	Uji i faturuar	m ³	4,389,541	4,558,740	4,535,956	103.34%	99.50%
	Konsumatorët	Nr	40,174	40,086	42,110	104.82%	105.05%
GJI	Uji i prodhuar	m ³	8,616,001	8,020,062	9,087,374	105.47%	113.31%
	Uji i humbur	m ³	4,486,555	3,141,397	4,722,284	105.25%	150.32%
	Uji i faturuar	m ³	4,129,446	4,878,665	4,365,090	105.71%	89.47%
	Konsumatorët	Nr	37,869	40,431	39,409	104.07%	97.47%
SEKTORI	Uji i prodhuar	m³	183,413,865	149,630,451	200,532,353	109.33%	134.02%
	Uji i humbur	m³	111,554,279	68,841,368	126,601,277	113.49%	183.90%
	Uji i faturuar	m³	71,859,586	80,789,083	73,931,076	102.88%	91.51%
	Konsumatorët	Nr	462,398	466,512	481,510	104.13%	103.21%

2.2 PERFORMANCA FINANCIARE-FURNIZIMI ME UJË

2.2.1 Vlera monetare e shitjeve

Edhe gjatë këtij viti, vlera e realizuar e shitjeve për çdo KRU rezultoi më e ulët krahasuar me vlerën e planifikuar (shih Figurën 11). Ky rezultat lidhet kryesisht me parashikimet jo të sakta të volumeve të shitjeve, siç është shpjeguar në treguesin më sipër.




Figura 11. Përqindja e shitjeve (faturimit në Euro) në raport me planin

Mesatarja e realizimit të shitjeve në vlerë monetare në nivel sektori për vitin 2024 ishte për 7.6% më e ulët krahasuar me planifikimin, duke shënuar një përkeqësim të vogël edhe në raport me realizimin e vitit 2023. Shumica e kompanive nuk arritën ti përmbushin objektivat e shitjeve të planifikuara sipas BPRR-2024, të aprovuara nga rregullatori.

Në nivel të kompanive, performanca më e mirë edhe këtë vit u shënuar nga KRU Bifurkacioni, e cila realizoi më 103% të caktuar, duke tejkaluar planifikimet për për 3%. Në anën tjetër, KRU Gjakova mbetet me performancën më të dobët me vetëm 79% të realizimit, duke shënuar një rënie të mëtejshme krahasuar me vitin paraprak.

Nën-vlerësimi i volumeve dhe vlerës së shitjeve ka ndikuar drejtpërdrejt në kapacitetin financiar të KRU-ve, duke reduktuar burimet e nevojshme për realizimin e planeve të investimeve. Megjithatë, pavarësisht këtij dështimi për të arritur caqet e planifikuara, vlera absolute e shitjeve ka shënuar rritje, e cila i atribuohet kryesisht rritjes së numrit të konsumatorëve dhe për rrjedhojë rritjes së shitjeve volumetrike.


Tabela 5 më poshtë paraqet shifrat statistikore të performancës së shitjeve të ujit krahasuar me vlerësimet e planifikuara, të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU-ve gjatë procesit tarifor për vitet 2023 dhe 2024.

Tabela 5. Vlera e shitjeve të realizuara dhe planifikuara 2023-2024

KRU	Vlera e shitjeve (Euro)						Raporti: realizimi 2024/realizimi 2023
	2023			2024			
	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	Planifikuar	Realizuar	raporti: real./plan.	
PR	14,959,849	14,019,707	94%	15,214,523	14,693,787	96.6%	4.81%
PZ	4,669,478	4,084,655	87%	4,868,749	4,261,696	88%	4.33%
PE	3,714,437	3,414,919	92%	3,834,861	3,457,514	90%	1.25%
MIT	3,780,411	3,592,873	95%	3,853,362	3,694,393	96%	2.83%
GJA	4,772,622	3,802,406	80%	4,957,019	3,925,127	79%	3.23%
FE	2,204,247	2,237,216	101%	2,291,137	2,368,741	103%	5.88%
GJI	2,234,101	2,022,290	91%	2,356,907	2,134,552	91%	5.55%
Sektori	36,335,145	33,174,065	91%	37,376,559	34,535,811	92%	4.10%

Vlera e shitjeve monetare të realizuara për vitin 2024 në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte rreth 34.5 mil. Euro përderisa ajo e planifikuar ishte 37 mil. Euro, që do të thotë rreth 2.8 mil. euro më pak të realizuara. Krahasimi me vitin 2023 tregon se, megjithëse vlera absolute e shitjeve është rritur për shkak të zgjerimit të bazës së konsumatorëve, niveli i realizimit në raport me planifikimin ka mbetur i ulët.

Kjo situatë tregon se të ardhurat e sektorit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha nevojat financiare, përfshirë mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese dhe investimet kapitale. Tendencat e vazhdueshme të nënrealizimit të caqeve volumetrike dhe monetare evidenton sfidat e përgjithshme të sektorit në planifikimin dhe menaxhimin e të ardhurave.

**Figura 12. Përqindja e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2024 në raport me vitin 2023**

Nga Figura 12, shihet se gjatë vitit 2024, gjashtë nga shtatë KRU-të kanë shënuar progres në realizimin e shitjeve krahasuar me vitin 2023. Në linjën e rezultateve më të larta, KRU Bifurkacioni ka arritur të këtë përqindjen më të madhe prej 5.88%, e cila lidhet kryesisht me zgjerimin e bazës së konsumatorëve në shërbimin e ujësjellësit, duke ndikuar pastaj në rritjen e shitjeve volumetrike për 14%.

Ndërkohë KRU Hidrodrini mbetet me nivelin më të ulët të shitjeve të realizuara në raport me vitin paraprak dhe atë me 1.25%.

Shitjet në nivel sektori në 2024 janë më të larta për 4.1% në raport me vitin 2023 si rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike për 3%. Ky rezultat tregon një përmirësim të lehtë të performancës në sektor, megjithëse niveli i realizimit ende mbetet nën objektivat e planifikuara.

2.2.2 Kostoja për njësi

Kostot për njësi janë analizuar përmes tre treguesve kryesorë:

- **Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar,**
- **Kostoja totale operative për njësi të ujit të prodhuar, dhe**
- **Kostoja totale për njësi të ujit të shitur.**

Të dhënat statistikore për secilin nga këta tregues paraqiten në figurat në vijim.

2.2.3 Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar

Ky tregues mat shpenzimet mesatare që ndodhin për prodhimin e një metri kub ujë (1 m^3) dhe është një indikator i rëndësishëm financiar për vlerësimin e efikasitetit operativ të KRU-ve. Ai shërben si bazë për analizimin e kostove të prodhimit dhe identifikimin e mundësive për reduktimin dhe përmirësimin e shpenzimeve operative.




Figura 13. Kostoja operative njësi e ujit të prodhuar (EUR/m³ të ujit të prodhuar)

Në nivel të sektorit, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar, në terma reale ka shënuar rënie nga 0.047 €/m^3 sa ishte në vitin 2023 në 0.043 €/m^3 për vitin 2024.

Edhe pse këto kosto për njësi shfaqen të vogla në krahasim me tarifën mesatare duhet pasur parasysh nivelin e lartë të humbjeve së bashku me efikasitetin e dobët në arkëtimin e të ardhurave, ku duhen përafërsisht rreth 2.27 m^3 të ujit të prodhuar për të gjeneruar 1 m^3 të ujit të shitur dhe të paguar për të.

Kosto dukshëm më e ulët në vitin 2024 në raport me vitin 2023 është shënuar tek KRU Bifurkacioni, Hidroregjioni Jugor dhe Hidrodrini edhe për faktin se në vitin 2024 nga këto kompani është raportuar një sasi shumë më e madhe e ujit të prodhuar.

Në rastin tjetër të KRU Hidromorava dhe Hidroregjioni Jugor kostoja është tejet e lartë dhe e ndikuar nga shpenzimet e larta të energjisë për operim të stacioneve të shumta pompuese, të dyja këto kompani kanë një sistem të fragmentuar të burimeve të ujit me kapacitete të vogla furnizuese, e tek KRU Hidromorava shpenzimet rriten edhe për shkak të përpunimit të ujit në tre impiante.

2.2.4 Kostoja operative për njësi të ujit të shitur

Kostoja totale operative për njësi të ujit të shitur paraqet shpenzimet totale që ofruesit e shërbimeve krijojnë për furnizim të ujit tek konsumatori, e që përfshinë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale për furnizim me ujë, por duke përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija³, të gjitha këto, në raport me vëllimin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.




Figura 14. Kostoja operative për njësi e ujit të shitur (€ për m³ ujë të shitur)

Në vitin 2024, në nivel sektorial, kostoja për njësi e furnizimit me ujë ishte 0.46 €/m³, duke shënuar rritje negative prej 0.04 €/m³ ose 9% krahasuar me vitin 2023.

Siç shihet në figurë, ekziston një shpërndarje e gjerë në nivel te kompanive sa i përket kostos totale për njësi të ujit të shitur dhe që nuk ka të njëjtën shpërndarje sikur kostoja për njësi të ujit të prodhuar.

KRU Hidrodrini ka nivelin më të ulët të koston së ujit të shitur krahasuar me të gjitha kompanitë tjera me 0.41 €/m³, deri tek ajo më e larta që është për KRU Gjakova dhe KRU Mitrovica me 0,50 €/m³.

KRU Hidromorava dhe KRU Hidroregjioni Jugor, që kishin koston më të lartë për njësi të ujit të prodhuar, tani pozicionohen në nivele më të ulëta për ujin e shitur: përkatësisht 0.48 €/m³ dhe 0.49 €/m³.

Një rritje e theksuar e koston për njësi është vërejtur tek KRU Hidrodrini, ku nga 0.28 €/m³ në vitin 2023 ka arritur në 0.41 €/m³ në vitin 2024 – një rritje prej 45%. Kjo lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve operative

³ Në përputhje me Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit borxhet e këqija në këtë raport janë të definuara si shuma e të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak.

për furnizim me ujë, me theks shpërndarja e shpenzimeve jo adekuate në mes të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura. Edhe KRU Prishtina ka pasur rritje të kostos së ujit të shitur për 9%, kjo rritje e kostos edhe në këtë rast i atribuohet kryesisht rritjes së shpenzimeve të kontraktuara dhe rritjes së shpenzimeve të pagave të personelit. Përderisa tek KRU Hidroregjioni Jugor rritja është shkaktuar si rezultat i shtimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe ngarkesës së shërbimeve.

2.2.5 Kostoja njësi e ujit të shitur, realizimi kundrejt planifikimit

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujësjellës është një tregues financiar që bën pjesë në grupin e treguesve kryesorë përmes të cilëve matet performanca e shërbimeve të ujësjellësit. Ky tregues, i paraqitur grafikisht më poshtë, tregon raportin ndërmjet: kostos për njësi të realizuar (shpenzimet operative, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale, të ndara me sasinë e ujit të faturuar në m³), dhe kostos për njësi të planifikuar (shpenzimet operative të planifikuara, përfshirë mirëmbajtjen kapitale, të ndara me sasinë e ujit të faturuar në m³).




Figura 15. Kostoja për njësi e ujit të shitur në raport me kostot e planifikuara për njësi

Përbushja e kostove të planifikuara për njësi gati në të gjitha kompanitë ishin tejkaluar, pra ishin mbi nivelin prej 90%, dhe kjo nuk tregon një performancë të mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukurore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që këto kompani nuk kanë arritur ti realizojnë shumicën prej tyre.

Sugjerohet që KRU-të të alokojnë dhe realizojnë shpenzimet operative, veçmas rritjen e investimeve kapitale në asete infrastrukurore (ripërtëritje e rrjetit), pasi jemi të sigurt se kjo do të sjellë përmirësim të dëshiruar në cilësinë e nivelit të shërbimit.

2.2.6 Investimet kapitale për ujësjellës

Përmes proceseve tarifore, ARRU, në baza vjetore, aprovon shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare për KRU-të dedikuar investimeve kapitale për mirëmbajtje dhe përtëritje të aseteve, e vlerësuar si e domosdoshme për të ofruar shërbime të qëndrueshme të furnizimit me ujë. Po ashtu KRU-të në planin e

biznesit rregullator planifikojnë investime të konsiderueshme nga donacionet (grante nga institucionet qeveritare dhe donatorët) të cilë janë në përkraje të sektorit.

Tabela 6. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake

Burimet vetanake të investimit					
KRU	2023	2024			% krahasuese: 2024/2023 (realizim)
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2024: realizim/ planifikim	
PR	701,478	1,616,600	762,012	47.1%	9%
PZ	493,986	677,000	691,741	102.2%	40%
PE	409,285	865,500	1,169,117	135.1%	186%
MIT	79,148	390,000	116,999	30.0%	48%
GJA	915,233	937,480	666,116	71.1%	-27%
FE	148,353	311,990	310,425	99.5%	109%
GJI	170,908	335,530	421,796	125.7%	147%
Spektori	2,918,390	5,134,100	4,138,206	80.6%	42%

Në vitin 2024 përmes procesit tarifor në total ishin aprovuar në nivel sektori rreth 5.1 mil. € për kostot kapitale në shërbimin e furnizimit me ujë dhe ishin më tepër për 0.4 mil. € se në vitin 2023. Janë realizuar rreth 4.1 mil. € apo 80.6% nga ajo që ishte aprovuar.

Përqindjen me të lartë të investimeve kapitale nga burimet vetanake, në raport me planin në vitin 2024, e ka realizuar KRU 'Hidrodrini' me 135%, e pasuar nga KRU 'Hidromorava' me 125%. Është për t'u theksuar se krahasuar me vitin paraprak ka një rritje të realizimit të investimeve kapitale. Përqindja shumë e lartë krahasuese: 2024/2023 (realizim) për KRU 'Hidrodrini' është se në vitin 2023 ka pasur një shumë modeste të investuar.

Mungesa e investimeve, sidomos e atyre të dedikuara për mirëmbajtje dhe ripërtëritje kapitale, padyshim se rezultojnë me përkeqësim të bazës së asetëve dhe rënie të nivelit të shërbimit, me trend në rritje të defekteve në rrjet si dhe nivel të lartë të humbjeve të ujit në sistemin shpërndarës.




Figura 16. Shpenzimet kapitale të realizuara nga të hyrat vetanake në raport me planin

Tabela 7. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet

KRU	Investimet prej granteve				% krahasuese: 2024/2023 (Realizim)
	2023	2024			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2024: realizim/planifikim	
PR	115,197	0	169,786	/	47%
PZ	324,400	11,097,500	156,051	1.4%	-52%
PE	0	0	150,000	-	-
MIT	1,916,121	0	39,237	-	-98%
GJA	446,653	14,600,068	12,478	0.1%	-97%
FE	1,707,022	325,000	479,352	147.5%	-72%
GJI	843,376	5,400,000	606,414	11.2%	-28%
Sektori	5,352,769	31,422,568	1,613,318	5.1%	-70%

Shuma monetare në vlerë e prej 31 mil. Euro ishte planifikuar të sigurohet dhe të investohet prej granteve nga donatorë për vitin 2024. Nga kjo shumë është realizuar rreth vetëm 1.6 mil. Euro apo 5.1%, që në raport me vitin 2023 është me e ulët për 3 herë. Shumica e vlerës së projeksioneve, ishin paraparë nga KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Gjakova dhe KRU Hidromorava, përderisa realizimi ishte shumë më i ulët se planifikimi.

Për vitin 2024, KRU Prishtina, KRU Hidrodrini, dhe KRU Mitrovica nuk kishin planifikime të investimeve nga donatorët, megjithatë në këto kompani janë realizuar rreth 0.4 mil. Euro.




Figura 17. Shpenzimet kapitale të realizuara nga grantet në raport me planin

Tabela 8. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet

	Burimet vetanake të investimit + grantet				% krahasuese: 2024/2023 (realizim)
	2023	2024			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	Investimet kapitale (realizuar)	
Sektor-Investime Vetanake	2,918,390	5,134,100	4,138,206	80.60%	42%
Sektor-Investime Grante	5,352,769	31,422,568	1,613,318	5.13%	-70%
Sektor	8,271,159	36,556,668	5,751,525	15.7%	-30%

Nga tabela 8. vërehet se realizimi i investimeve kapitale në vitin 2024, në nivel sektori nga mjetet vetanake dhe donacionet ishte me i ulët se në vitin e kaluar për rreth 2.5 mil. €.




Figura 18. Shpenzimet kapitale të realizuara nga të hyrat vetanake dhe grantet n raport me planin

Nga totali i investimeve kapitale (vetanake dhe grante) në shërbimin e furnizimit me ujë si mesatare e sektorit janë realizuar 15.7%. Më shumë investime janë realizuar nga KRU Hidrodrini, për faktin se planifikimet nga grantet ishin 0 Euro, e kjo ka bërë që realizimi ti tejkaloj shumëfish planifikimet. KRU Bifurkacioni po ashtu ka tejkaluar planifikimet për sa i përket investimeve nga grantet për 147.5%, ndërsa si shumë kumulative e investimeve nga financat vetanake dhe granteve ka tejkaluar planifikimet për 124%. Të gjitha KRU-të tjera kanë ngecur në përmbushjen e planifikimeve.

2.3 PERFORMANCA OPERATIVE-SHËRBIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

2.3.1 Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Në vitet e fundit, trajtimi i ujërave të ndotura është bërë prioritet i investimeve të institucioneve vendore dhe donatorëve ndërkombëtarë. Në fund të vitit 2024, në gjithë Kosovën janë në funksion gjashtë impiante trajtimi të ujërave të ndotura, të menaxhuara nga KRU-të përkatëse.

Këto impiante përfshijnë:

- ITUN në Skënderaj, që trajton ujërat e ndotura të vendbanimeve Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm dhe Tërnavc, menaxhuar nga KRU Mitrovica;
- ITUN në Mramor dhe Harilaç, përkatësisht për këto dy vendbanime, menaxhuar nga KRU Prishtina;
- ITUN në Prizren, për një pjesë të zonës urbane të qytetit, nën menaxhimin e KRU Hidroregjioni Jugor;
- ITUN në Pejë, për një pjesë të qytetit dhe vendbanimin Qyshk, menaxhuar nga KRU Hidrodrini;
- ITUN në Gjakovë, për një pjesë të qytetit, nën menaxhimin e KRU Gjakova.

Në kuadër të këtyre impianteve janë ndërtuar laboratore të pajisura me teknologji moderne dhe staf të trajnuar, por ende nuk janë akredituar nga agjencioni përgjegjës vendor. Rekomandohet që agjencitë projekt-zbatuese dhe donatorët të financojnë edhe procesin e akreditimit të laboratorëve dhe certifikimin e personelit.

Rezultatet e analizave laboratorike tregojnë se shumica e testeve janë brenda standardeve vendore ku prej 2,687 mostrave vetëm 8 prej tyre nuk janë në përputhje me vlerat e lejuara sipas standardeve.

2.3.2 Shpeshësia e bllokimit të rrjetit të kanalizimit

Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit tregon performancën operative të sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura.




Figura 19. Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit

Vlerësimi i numrit të bllokimeve në rrjetin e kanalizimit duhet të bëhet me rezervë, pasi shumica e Kompanive Rajonale të Ujit nuk e kanë të digjitalizuar tërë rrjetin e kanalizimit. Në shumicën e rasteve, raportimet për bllokimet përfshijnë vetëm pjesën e rrjetit që është e përfshirë në sistemin GIS, ndërsa rrjeti real është shumë më i gjatë dhe më kompleks sesa segmenti i digjitalizuar. Kjo krijon një mospërputhje të mundshme mes realitetit në terren dhe të dhënave të raportuara, dhe rrezikon të nënvlerësojë ose të mos përfaqësojë plotësisht shkallën e problemeve në rrjetin e kanalizimit.

KRU Hidrodrini ka numrin më të lartë të defekteve në rrjetin e kanalizimit ku gjatë vitit 2024 në raport me 2023 ka shënuar rritje prej 79%. Kjo është një shenjë serioze për degradim të rrjetit të kanalizimit ose mungesë të mirëmbajtjes.

Kompanitë si KRU Gjakova, Mitrovica dhe KRU Bifurkacioni kanë shënuar një ulje të numrit të defekteve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së analizuar.

Në anën tjetër, menaxhimi i të dhënave për bllokimin dhe dështimin e rrjetit të kanalizimit nuk është i kënaqshëm meqenëse asnjëra nga kompanitë nuk kanë qenë azhure në përditësimin e të dhënave në modulet softuerike respektive.

2.3.3 Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim) përkufizohet si përqindje e popullsisë, brenda zonës së shërbimit, që kanë shërbime të kanalizimit nga KRU.




Figura - 20 Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura gjatë vitit 2024 në nivel sektori ka shënuar progres të për 3% krahasuar me vitin paraprak dhe ka arritur në nivelin 69%.

Gjatë vitit 2024, shumica e KRU-ve kanë shënuar progres sa i përket mbulueshmërisë së shërbimeve me ujëra të ndotura, me përmirësim prej 7% KRU Gjakova dhe KRU Hidrodrini dhe me 5% KRU Prishtina dhe KRU Hidromorava. Dy prej KRU-ve si KRU Bifurkacioni dhe KRU Mitrovica kanë përjetuar ulje të lehta, duke treguar nevojën për vëmendje të mëtejshme në përmirësimin e këtij shërbimi.

Përmirësimi i treguesit të mbulueshmërisë me shërbimet e ujërave të ndotura gjatë vitit 2024 në raport me vitin 2023 është ndikuar edhe nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë, i cili ka mundësuar përditësimin dhe saktësimin e të dhënave demografike.

Trajtimi i ujërave të ndotura në nivel sektori vazhdon të jetë në nivele të ulëta. Aktualisht vetëm 11.08% e popullsisë janë të kyçur në impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura, çka tregon një përfshirje minimale të shërbimit në raport me nevojat reale. Për më tepër, raporti ndërmjet vëllimit të përgjithshëm të ujërave të ndotura të grumbulluara (dhe të faturuara) ndaj vëllimit të ujit të trajtuar në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) është vetëm 22%.

2.3.4 Ankesat për shërbimet e ujërave të ndotura

Treguesi i mëposhtëm paraqet numrin e ankesave që konsumatorët i drejtojnë kompanive të tyre, lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura. Në këtë shifër janë përfshirë vetëm ankesat me natyrë teknike.

Ndërkaq, ankesat me karakter komercial, të adresuara tek Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU), përfshijnë të dyja shërbimet: furnizimin me ujësllës dhe shërbimin e ujërave të ndotura.

Tabela 9. Ankesat e konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura

KRU	Ankesat teknike	
	2023	2024
PR	10	3,668
PZ	65	557
PE	3,092	3,484
MIT	94	1,320
GJA	552	229
FE	0	1
GJI	21	3
Sektori	3,834	9,262

Njëjtë si tek shërbimi i ujit të pijshëm, menaxhimi i ankesave në disa KRU ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm. Aktualisht, të dhënat për ankesat nuk regjistrohen, klasifikohen, mirëmbahen apo raportohen në përputhje me kërkesat e ARRU-së. Kjo ka shkaktuar diferenca të mëdha në numrin e ankesave të raportuara për vitet 2024 dhe 2023, duke ulur besueshmërinë e këtij treguesi.

Rekomandojmë që KRU-të të tregojnë më shumë përgjegjësi në regjistrimin dhe mirëmbajtjen e databazës së ankesave për ujërat e ndotura. Gjithashtu, duhet të funksionalizojnë dhe përdorin në mënyrë efektive aplikacionet softuerike (CRM), në mënyrë që ankesat e konsumatorëve lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura të azhurnohen dhe përditësohen vazhdimisht, duke përmirësuar kështu cilësinë e menaxhimit dhe raportimit.

2.4 PERFORMANCA FINANCIARE-SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

2.4.1 Faturimi (shitjet) i shërbimeve të ujërave të ndotura

Vlera e shitjeve për shërbimet e ujërave të zeza drejtpërdrejt është e lidhur me volumet e shitjeve të ujit. Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit të disa nga kompanitë krahasuar me shitjet e planifikuara vlera e shitjeve aktuale të shërbimeve të ujërave të ndotura gjithashtu është nën vlerat e planifikuara të shitjeve (shih Figurën 19).




Figura 21. Shitjet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Pavarësisht se nuk janë arritur caqet e shitjeve tek të gjitha kompanitë, të ardhurat nga shitjet për shërbimet e ujërave të ndotura në terma real aktualisht janë rritur për 3% edhe pse kryesisht kjo ishte për shkak të performancës së përmirësuar komerciale.

Disa nga KRU-të nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të ndotura gjatë vitit 2024 në përjashtim të KRU Hidrodrini, dhe KRU Bifurkacioni e cila madje i ka tejkaluar objektivat e planifikuara për 9% .

Kompania e cila ka arritur ta këtë performancën me të dobët në realizimin e shitjeve të ujërave të ndotura është KRU Mitrovica me 91%, njëkohësisht me një rritje prej 1% krahasuar me vitin paraprak 2023.

2.4.2 Vlera monetare e realizuar e faturimit (shitjeve) të shërbimit të ujërave të ndotura

Vlera monetare e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura paraqet një komponent të rëndësishëm të të ardhurave operative të KRU-ve, duke ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen e tyre financiare. Në vitin 2024, kjo vlerë në terma real ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2023, çka tregon përmirësim të performancës financiare si rezultat i rritjes së bazës së faturimit bazuar në rritjen e bazës së konsumatorëve.




Figura 22. Vlera monetare e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotur gjatë 2024 në raport me 2024

Gjatë vitit 2024 shitjet e shërbimeve të ujërave të ndotura ka shënuar rritje në krahasim me vitin 2023. Rritja më e madhe vërehet te KRU Gjakova me 19% dhe KRU Hidrodrini me 15%, ndërsa rritje të moderuar kanë pasur edhe kompanitë e tjera nga 0.57%-5.55%.

Në nivel të sektorit vlera monetare e shërbimeve është rritur për 7% duke kaluar nga 6.4 milion euro sa ishte në vitin 2023 në 6.9 milion euro në vitin 2024.

Për dallim nga shërbimet e ujit ku KRU Bifurkacioni printe me nivelin më të lartë të shitjeve krahasuar me vitin parapak, tek ujërat e ndotura rezultojnë me nivelin më të ulët prej 0.57%, përkundrazi rritjes së bazës së konsumatorëve e pastaj edhe rritjes së shitjeve volumetike të ujërave të ndotura.

2.4.3 Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale për konsumatorët shtëpiak të shërbyer⁴.




Figura 23. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura (Euro/kons. vit)

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale për konsumatorët shtëpiak të shërbyer.

Kostot për njësi për vitin 2024 dhe 2023 janë të paraqitura në figurën 21. Këto kosto për njësi janë shumë të ulëta në krahasim me kostot e shërbimeve të ujërave të ndotura në shumë prej ekonomive të tjera perëndimore, kryesisht për shkak të faktit se nuk ka shpenzime të trajtimit, përjashtuar KRU Hidoregjionin Jugor, KRU Hidrodrini dhe KRU Gjakova të cilat kanë filluar me këtë shërbim. Kostoja mesatare për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2024 ka treguar rënie prej 5% krahasuar me vitin 2023, nga 12.60 euro/kons.vit në 12.01 euro/kons.vit. Ky trend i rënies i atribuohet rritjeve së bazës së konsumatorëve perkundër rritjes së shpenzimeve totale për ujëra të ndotura.

2.4.4 Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Me procesin tarifor për vitin 2024, ARRU ka aprovuar investime kapitale (mirëmbajtje kapitale dhe rritje kapitale) me qëllim KRU të sigurojnë nivele më të kënaqshme të shërbimit të ujërave të ndotura.

⁴ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohej si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

Tabela 10. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake

Burimet vetanake të investimit					
KRU	2023	2024			
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2024: realizim / planifikim	% krahasuese: 2024 / 2023
PR	44,334	597,000	68,848	11.5%	55%
PZ	1,321	197,000	103,396	52.5%	7726%
PE	112,348	50,000	151,362	302.7%	35%
MIT	4,710	150,000	12,250	8.2%	160%
GJA	15,264	196,000	11,430	5.8%	-25%
FE	16,179	112,928	5,156	4.6%	-68%
GJI	109,670	116,112	53,866	46.4%	-51%
Sektori	303,826	1,419,040	406,308	28.6%	34%

KRU-të në total nga mjetet e vatanake, kishin planifikuar investime në shërbimin e ujërave të ndotura rreth 1.4 mil. Euro, përderisa ishin realizuar vetëm 28.6% të tyre. Investimet kapitale të realizuara në vitin 2024 në infrastrukturën e ujërave të ndotur ishin rreth 0.4 mil. Euro, që është për 34% më e lartë se në vitin 2023, por prap është shumë e vogël krahasuar me gjendjen dhe nevojat e në këtë sektor.

Cakun e investimeve ka përmbushur vetëm KRU Hidrodrini madje duke tejkaluar atë, kjo për faktin sepse vlera e planifikuar për investime ka qenë shumë e ulët. Të gjitha KRU-të kanë dështuar të përmbushin shumën e planifikuar të investimeve dhe ARRU është shumë e brengosur me këtë trend.



**Figura .24 Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura nga të hyrat vetanake në raport me planin**

Tabela 11. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga grantet

KRU	Investimet prej granteve				
	2023	2024			% krahasuese: 2024 / 2023
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2024: realizim / planifikim	
PR		54,150,000	7,049	0.01%	/
PZ	-	12,810,000	4,213,032	32.89%	/
PE	2,290,017	-	140,970	/	-94%
MIT	-	-	-	/	/
GJA	15,366,066	-	505	/	-100%
FE	-	300,000	3,800	1.27%	/
GJI	-	-	-	/	/
Sektori	17,656,083	67,260,000	4,365,356	6.49%	-75%

Kompanitë për vitin 2024 kishin planifikuar investime nga grantet (qoftë investime nga institucionet qeveritare apo donatorët) në shumë prej 67 mil. Euro, nga kjo shumë janë realizuar vetëm 4 mil. Euro, gjegjësisht 6.5%, kryesisht janë investime të realizuara nga KRU Hidroregjioni Jugor dhe KRU Bifurkacioni.

**Figura .25 Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura nga grantet në raport me planin****Tabela 12. Investimet e realizuara dhe planifikuara nga të hyrat vetanake dhe grantet**

	Burimet vetanake të investimit + grantet				
	2023	2024			% krahasuese: 2024/2023
	Investimet kapitale (realizuar)	Investimet kapitale (planifikim)	Investimet kapitale (realizim)	% krahasuese 2024: realizim/ planifikim	
Sektori-Investime Vetanake	303,826	1,419,040	406,308	28.6%	34%
Sektori-Investime Grante	17,656,083	67,260,000	4,365,356	6.5%	-75%
Total Sektori	17,959,908	68,679,040	4,771,664	6.95%	-73%

Në total në sektorin e shërbimeve të ujërave të ndotura, nga mjetet e planifikuara te investohen nga KRU-të, por edhe nga grantet ishin realizuar 6.95 investime te projektuar nga vitet e kaluar.




Figura .26 Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në raport me planin

ARRU pret nga KRU-të që të bëjnë planifikime më reale të investimeve, si në vlerë monetare po edhe në afatet kohore të kryerjes së investimeve. Praktika e planifikimeve pa një siguri të lartë se investimet e propozuara do të realizohen duhet të ndërpritet.

2.5 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E OFRUESVE TË SHËRBIMIT

2.5.1 Arkëtimi i të ardhurave

Në vijim paraqitet performanca e kompanive sa i përket treguesit shkalla e arkëtimit për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023. Ky tregues është llogaritur si raport ndërmjet arkëtimit të mjeteve monetare (cash) dhe faturimit të rregullt për shërbimet e ofruara të ujësllësit dhe ujërave të ndotura, duke përfshirë taksat e kyçjes dhe të ardhurat e tjera operative.

Ky është një ndër treguesit më domethënës, i cili përveçse reflekton efikasitetin në faturim dhe reduktimin e humbjeve të ujit, ka gjithashtu ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Figura 27. Shkalla e arkëtimit

Niveli aktual i shkallës së arkëtimit prej 104% është 2% më i lartë krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje është e evidente në të gjitha KRU, kryesisht si rezultat i arkëtimit të lartë të të ardhurave nga kategoria e konsumatorëve shtëpiak, pavarësisht rritjes së të ardhurave të faturuara.

KRU Hidromorava prin me shkallën më të lartë të arkëtimit në raport me kompanitë e tjera, duke arritur nivelin prej 114%, e njëkohësisht edhe me përmirësimin më të madh krahasuar me vitin paraprak. Ky rezultat është arritur falë arkëtimit të lartë të faturave të papaguara nga konsumatorët komercial, ku shkalla e arkëtimit në këtë kategori ka pas rritje prej 6%, nga 98% sa ishte vitin e kaluar në 104%. Performues të mirë në këtë tregues kanë qenë gjithashtu KRU Prishtina, KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Gjakova dhe KRU Mitrovica, të cilat arritën efikasitet të lartë në arkëtim.

Nga ana tjetër, KRU Hidrodrini ka treguar përqindjen më të ulët të realizimit të arkëtimit krahasuar me mesataren e sektorit, duke dëshmuar sfida në përmirësimin e arkëtimit. Kjo mbetet një pike e dobët që kërkon vëmendje shtesë në menaxhim dhe implementimin e masave për rritjen e efikasitetit.

Në nivel të sektorit, objektiva e planifikuar në procesin tarifor për vitin 2024 ka qenë 93%, ndërsa niveli i arritur aktualisht është 11% më i lartë se plani duke dëshmuar jo vetëm përmbushjen e planit por edhe

tejkalimin e pritjeve në shumicën e kompanive - përjashtim bën vetëm KRU Hidrodrini, e cila vazhdon të mbetet larg caceve të planifikuara.




Fig. 28. Arkëtimi i realizuar/Arkëtimi i panifikuar për vitin 2024

Tabela 13. Vlera e shkallës së arkëtimit të realizuar në raport me objektivat për 2023 dhe 2024

Shkalla e inkasimit	Realizimi		Objektiva	
	2023	2024	2023	2024
KRU				
PR	105%	107%	94%	94%
PZ	100%	106%	94%	94%
PE	84%	90%	94%	94%
MIT	105%	100%	87%	88%
GJA	104%	106%	95%	95%
FE	105%	98%	93%	93%
GJI	110%	114%	94%	94%
Sektori	102%	104%	93%	93%

Sic vërehet nga tabela, sektori ka dëshmuar një efikasitet të lartë duke tejkaluar objektivat për dy vite radhazi (102% në vitin 2023 dhe 104% në vitin 2024). Ky trend rritës tregon përmirësim të vazhdueshëm në shkallën e arkëtimit dhe reflekton menaxhim më efektiv të të hyrave. Kompanitë më të suksesshme në realizimin e planifikimeve janë KRU Hidromorava dhe KRU Prishtina, të cilat kanë kontribuar dukshëm në këtë performancë pozitive. Niveli i lartë i realizimit është rezultat kryesor i inkasimit të faturave nga konsumatorët shtëpiak, ndërsa një ndikim plotësues vjen edhe nga konsumatorët industrialë.

Një analizë e performancës së arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve është prezantuar në tabelën 14.

Tabela 14. Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2023-2024


Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Amvisëri	106%	111%	101%	107%	87%	91%	100%	104%	105%	108%	100%	101%	114%	117%
Komercial-industrial	106%	99%	98%	111%	81%	89%	110%	87%	97%	95%	102%	93%	98%	104%
Institucione	101%	100%	94%	91%	73%	84%	145%	88%	111%	107%	195%	56%	96%	93%
Mesatarja	105%	107%	100%	106%	84%	90%	105%	100%	104%	106%	105%	98%	110%	114%

Nga tabela me lartë vërejmë së në shumicën e kompanive arkëtimiti në kategoritë e konsumatorëve shtëpiak dhe industrial mbetet ende sfidë për tu përmirësuar.

Këtë vit, KRU Hidromorava mban rekordin me 117% të arkëtimit në amvisëri, përderisa KRU Hidrodrini mbetet me normën më të ulët dhe atë me vetëm 91% .

2.5.2 Kthimi ne kapital

Kostoja e kapitalit është një zë i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit të ujit, si e tillë ka impakt të rëndësishëm në ngarkesën tarifore, si tregues paraqet ndryshimin në mes të të ardhurave vjetore, shpenzimeve operative, mirëmbajtjes kapitale dhe të ardhurave të shlyera të cilat qëndrojnë në raport me bazën rregullatore të aseteve (BRRRA)⁵, për procesin aktual tarifar 2022-2024, vlera e kthimit në bazën rregullatore të aseteve e aprovuar nga ARRU është 4%.



⁵Për më shumë detaje mbi bazen rregullatore te aseteve mund ti gjeni në 'Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit të ARRU'.

Figura 29. Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRR)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit ka treguar trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 1.1% nga 2.6% sa ishte në vitin 2023 në 3.7% për vitin 2024.

Gjatë këtij viti, gjashtë nga shtatë kompanitë kanë realizuar norma pozitive të kthimit, ndërsa tri prej tyre madje kanë tejkaluar nivelin e planifikuar prej 4%. Kjo nënkupton se përveç mbulimit të plotë të shpenzimeve operative, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRR, këto kompani kanë krijuar hapësirë edhe për investime kapitale.

Nga ana tjetër, performanca më e dobët në vitin 2024 është evidentuar tek KRU Hidrodrini, e cila ka regjistruar normë kthimi -3.9%, duke shënuar një përkeqësim të theksuar krahasuar me vitin 2023. Ky rezultat negativ kryesisht lidhet me rritjen e shpenzimeve operative, përfshirë mirëmbajtjen kapitale, si dhe rritjen e provizionimit për borxhet e këqija, perkundër rritjes se lehtë të të hyrave të faturuara.

2.5.3 Shpenzimet operative

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar kostot operative të shtatë (7) ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë, për periudhën dy vjeçare aktuale 2024, krahasuar me vitin 2023.

Shpenzimet operative i referohen kostove të KRU-ve të domosdoshme për funksionimin, operimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, siç janë: shpenzimet e personelit, energjia elektrike, derivatet, kemikaliet së bashku me kostot e tjera administrative të lidhura me ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në tabelën 15, janë dhenë statistika të përmbledhura të shpenzimeve të përgjithshme për shërbimet e ujit të planifikuara si dhe ato të realizuara për vitin 2024 dhe 2023, në nivel sektori dhe specifikisht për secilën KRU, në vlera nominale.

Tabela 15. Vlera e shpenzimeve operative të realizuara dhe planifikuara

Shpenzimet operative	Realizimi		Planifikimi	
	2023	2024	2023	2024
KRU				
PR	11,714,925	13,503,281	11,749,032	12,097,435
PZ	4,644,903	4,972,704	4,725,555	4,885,130
PE	3,477,463	3,852,279	3,310,920	3,524,118
MIT	4,038,928	4,254,878	3,806,865	3,853,403
GJA	3,824,109	3,982,481	4,251,662	4,263,117
FE	2,146,347	2,212,876	1,958,826	1,970,391
GJI	2,078,121	2,074,094	1,872,187	1,878,888
Sektori	31,924,795	34,852,592	31,675,047	32,472,482

Në vitin 2024 për shtatë KRU-të, me proces tarifor, janë aprovuar rreth 32.4 mil. Euro shpenzime operative dhe nga kjo shumë janë realizuar 34.8 mil. Euro. Që do të thotë se KRU-të kanë realizuar pjesën e shpenzimeve në nivelin 107% , poshtu shpenzimet në vlera nominale në vitin 2024 ishin më të larta për 0.2 mil. Euro apo në normë 1%, në raport me vitin 2023.

Shpenzimet operative për furnizim me ujë janë rritur 2.9%, përderisa në shërbimin e ujërave të ndotura shpenzimet operative ishin me të larta për 0.4%. Tek furnizimi me ujë një rritje më e theksuar e shpenzimeve operative është raportuar nga KRU Hidrodrini dhe KRU Hidroregjioni Jugor, ku kanë pas rritje të shpenzimet e distribuimit të ujit.




Figura 30. Pjesëmarrja e kategorive të shpenzimeve operative për vitin 2024 dhe 2023

Shpenzimet e mëdha për personelin dhe në kategorinë e energjisë të cilat në vitin 2024 për KRU-të ishin 80%, (nga totali i shpenzimeve) e të cilat janë për 1.% më të larta se në vitin 2023 janë shpenzime që kanë ndikuar esencialisht në efikasitetin e KRU-ve.

Në bazë të analizave janë identifikuar shpenzime më të larta për: paga, energji, ngarkesa e shërbimeve dhe shërbime të kontraktuara, përderisa shpenzime me të ulëta ishin realizuar për: derivate, materiale dhe mirëmbajtje & riparime.

Shpenzime operative me të larta në kategorinë e pagave në raport me totalin e shpenzimeve janë raportuar tek KRU Bifurkacioni dhe KRU Gjakova me pjesëmarrje prej 74.6% dhe KRU Hidromorava me pjesëmarrje prej 73.3%, që është praktikë tejet e keqe dhe e njëjta duhet të përmirësohet.

Për sa i përket shpenzimeve të energjisë KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina kanë përqindjen më të lartë të kësaj kategorie të shpenzimeve.

Reduktimi dhe menaxhimi i shpenzimeve operative në mënyrë efektive është esencial dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në përfitimin financiar të kompanisë. Para se gjithash KRU-të duhet të kenë parasysh racionalizimin e kostove të personelit: rritjen e efikasitetit të stafit, zvogëlimin e UPF, përmirësimin i efikasitetit të energjisë etj.

2.5.4 Efikasiteti i stafit

Efikasiteti i stafit është tregues tipik menaxherial dhe tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt të angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura për t'ju shërbyer 1000 konsumatorëve.




Figura 31. Efikasiteti i stafit

Në vitin 2024 nuk është shënuar ndryshim në renditjen e KRU-ve sipas efikasitetit të stafit, ndërsa në nivel sektori është evidentuar një përmirësim i lehtë. Kompanitë arritën një raport mesatar prej 4.50 staf për 1,000 konsumatorë, krahasuar me 4.57 sa ishte në vitin 2023.

Ky përmirësim lidhet kryesisht me rritjen e numrit të konsumatorëve, veçanërisht si rezultat i ndërtimit të objekteve shumëkatëshe me apartamente të shumta, ku një pronar mund të zotërojë disa njësi banimi apo prona, të gjitha të regjistruara si konsumatorë të rinj. Gjithashtu, ndikim ka pasur edhe zgjerimi i zonave të shërbimit.

Ky konstatim mbështetet nga fakti se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve faturohen vetëm me taksë fikse, pa ngarkesë volumetrike, dhe besohet se kjo kategori merr pjesë me përqindje të konsiderueshme në bazën e konsumatorëve. Gjatë vitit 2024, numri i konsumatorëve të shërbyer është rritur me 19,112 apo rreth 4%.

KRU Gjakova, KRU Hidroregjioni Jugor, KRU Mitrovica, dhe KRU Bifurkacion kanë efikasitet më të dobët të stafit për 1,000 konsumatorë dhe radhiten mbi mesataren e sektorit që ka një vlerë mesatare të koeficientit të efikasitetit të stafit prej 4.57, e që mund të konsiderohet në nivel të pranueshëm për nivelin e automatizimit të proceseve nëpër impiantet e përpunimit të ujit dhe ujërave të ndotur.

Në anën tjetër planifikimi dhe realizimi i këtij treguesi të performancës është treguar në tabelën 16.

Tabela 16. Efikasiteti i realizuar dhe ai i planifikuar për vitin 2024

Efikasiteti i stafit	Realizimi	Planifikimi
KRU	Realizimi	Planifikimi
PR	2023	2024
PZ	3.72	3.50
PE	5.26	6.29
MIT	4.40	4.83
GJA	4.94	5.72
FE	5.91	6.43
GJI	4.87	6.17

Kompanitë edhe në këtë tregues kanë propozuar caqe sfiduese, të cilat janë përmbushur ose mbajtur në nivel të kënaqshëm nga të gjitha KRU-të, me theks të veçantë ka pasur përmirësime të mëdha tek KRU Bifurkacioni dhe KRU Hidroregjioni Jugor, megjithëse këto dy kompani ende janë mbi nivelin e mesatares së sektorit.

3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE Ibër Lepenci, e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina.

Në vazhdim, po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2024, në raport me vitin 2023.

Tabela 17. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2024 / 2023	2023	2024
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	45,544,034	48,766,009
Faturimi për ujin me shumicë (€)	1,319,454	1,447,559
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	1,451,255	1,444,112
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	2,156,148	1,976,488
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	63	56

Në vitin 2024, siç vërehet nga tabela më lart, shitjet e ujit në sasi janë rritur me 7% krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje i atribuohet kryesisht KRU Prishtina, ku shitjet u rritën nga 17.4 milionë në 20.1 milionë, apo për 16%, për KRU Mitrovica, rritja ishte më modeste, prej 2%, por gjithsesi kontribuoi në rritjen e shitjeve të ujit edhe në vlerë monetare.

Nga ana tjetër, shpenzimet për furnizimin me ujë me shumicë kanë rënë me 8%, nga 2.15 milionë në vitin 2023 në 1.97 milionë në vitin 2024. Ky ulje lidhet kryesisht me zvogëlimin e numrit të punëtorëve, që ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e shpenzimeve të personelit.

Në tabelën 18, paraqitet një pasqyrë e treguesve financiarë përmes të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE “Ibër Lepenci” për periudhën 2023–2024.

Tabela 18. Treguesit e performancës së NPH ‘Ibër-Lepenci’

Treguesi i performancës	2023	2024
Shkalla e arkëtimit	110%	100%
Norma e punës	0.61	0.73
Norma e mbulimit të punës	0.67	0.73
Kostoja e operimit për njësi (€/m ³)	0.047	0.041

Nga tabela 13, shihet se NHE Ibër Lepenci ka arritur shkallën e arkëtimit prej 100%, që nënkupton se të gjitha faturat për ujë të shitur me shumicë janë inkasuar plotësisht.

Zvogëlimi i shpenzimeve prej 8% dhe rritja e shitjeve të ujit prej 8%, ka ndikuar që norma e punës të jetë më e lartë krahasuar me vitin 2023. Edhe pse norma e mbulimit të punës është ngritur në raport me vitin 2023, prap mbetet nën nivelin e dëshiruar për të mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2024 për shërbimet e ofruara.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2024, kanë pësuar rënie në raport me vitin 2023 nga 0.047 euro/m³ në 0.041 euro/m³, si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të personelit.

BESUESHMËRIA DHE SAKTËSIA E TË DHËNAVE:

Mbledhja e rregullt, saktësia dhe besueshmëria e të dhënave janë thelbësore për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të shërbimeve të ujit. ARRU ka nevojë për këto të dhëna për të kryer misionin e tij mbikëqyrës, planifikues dhe rregullator në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në evidencë, me struktura të përditësuara rregullisht dhe në përputhje me kërkesat rregullative.

Për të siguruar cilësinë e të dhënave, ARRU realizon në baza vjetore aktivitetin e auditimit, respektivisht verifikimin e të dhënave të raportuara nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU). Verifikimi përqendrohet në saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave, si dhe në vlerësimin e kapaciteteve të sistemeve të ruajtjes së informacionit për të gjeneruar të dhëna të sakta, të besueshme dhe të verifikueshme. Ky vlerësim bazohet në “Modulin e Besueshmërisë së të Dhënave – 2024”, sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- **Nota 5** = 100%
- **Nota 4** = 76% – 90%
- **Nota 3** = 51% – 75%
- **Nota 2** = 26% – 50%
- **Nota 1** = 0% – 25%

Një **notë 1 (0%–25%)** tregon nivelin më të ulët të besueshmërisë, ndërsa një **notë 5 (100%)** tregon nivelin më të lartë të saj.

Besueshmëria e të dhënave në vitin 2024 është përmirësuar në pothuajse të gjitha KRU-të. Zhvillime pozitive janë evidentuar veçanërisht në KRU Bifurkacioni, Hidroregjioni Jugor dhe Hidrodrini. Në përgjithësi, vlera përfundimtare mesatare e besueshmërisë në tërë grupin e të dhënave për KRU sillet nga ajo me e ulta tek KRU Hidrodrini (77%) dhe Mitrovica (78 %) dhe tek ajo me e larta KRU Bifurkacion (86 %) dhe KRU Gjakova (83 %).

KRU Prishtina, ka shënuar një progres të vogël (1%) në besueshmërinë e përgjithshme krahasuar me vitin paraprak. Përmirësime janë vërejtur në përditësimin e të dhënave për konsumatorët, kontratat dhe stafin. Megjithatë, sfida mbeten ende në monitorimin e parametrave operativë të rrjetit (si presioni dhe vazhdimësia e furnizimit), si dhe në përditësimin e defekteve në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

KRU Hidroregjioni Jugor ka shënuar përmirësim prej 3%. Të gjitha burimet e ujit janë pajisur me ujëmatës, është përmirësuar procesi i raportimit dhe janë menaxhuar më mirë të dhënat për defektet në sistemin e ujësjellësit. Janë përditësuar edhe të dhënat për shpenzimet operative. Në të ardhmen, duhet të adresohen çështje të tilla si menaxhimi i presionit të ujit, krijimi i zonave DMA, digjitalizimi i sistemit të ujësjellësit, zhvillimi i GIS-it dhe avancimi i sistemit për menaxhimin e defekteve (MMS) edhe në sistemin e kanalizimit.

KRU Hidrodrini ka shënuar gjithashtu përmirësim prej 3%. Të gjitha burimet janë pajisur me ujëmatës dhe me sistem on-line raportimi, ndërsa ka përmirësime edhe në menaxhimin e të dhënave për konsumatorët. Sfidat vazhdojnë të jenë të ngjashme me ato të përmendura më sipër, si digjitalizimi i sistemit, krijimi i zonave DMA, avancimi i GIS-it. Në aspektin e menaxhimit të dhënave për ankesat e konsumatorëve, duhet avancuar dhe integruar moduli CRM.

KRU Gjakova, gjatë vitit 2024, ka realizuar disa përmirësime modeste, sidomos në monitorimin e presioneve, regjistrimin e defekteve dhe përditësimin e të dhënave për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Veçanërisht është përmirësuar moduli për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave (CRS). Në të ardhmen,

